



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:290181

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06630777

K.DH.SH. II.nr.2266/24

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i Kolegjit, Dren Rogova dhe Faton Bajrami anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit/propozuesit të masës së sigurimit “B V B” ShPK me NUI 810115552 seli në Prishtinë, i cili sipas prokurës përfaqësohet nga avokati Bedri Abdullahi me seli në Prishtinë, kundër të paditurit “Smart Project ShPK” me NUI 810177304 dhe seli në rrugën Ganimete Terbeshi nr. 26 në Prishtinë, të cilin në bazë të prokurës e përfaqëson avokati Skender Musa nga shoqëria e avokatëve “Avokatia Juridica” ShPK me seli në rrugën Richard Holbrooke p.nr. në Prishtinë, me objekt të kontestit pasurimi pabazë, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomave të shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.832/24 datës 18.11.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 17.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e propozuesve të sigurimit B V B” ShPK me NUI 810115552 seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.832/24 datës 18.11.2024, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale–Dhomat e shkallës së parë, për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor ka vendosur si në vijim: Refuzohet si i pabazuar propozimi i paditësit “B V B” ShPK me, me të cilin ka kërkuar caktimin e masës së sigurisë, ashtu që të paditurit “Smart Project ShPK” me NUI 810177304 t’i bllokohen të gjitha xhirrollogaritë që i ka të hapura në të gjitha bankat komerciale në Kosovë.

Kundër këtij aktvendimi kanë paraqitur ankesë të autorizuarit e propozuesit të sigurimit, me të cilën, e kundërshton aktvendimin e atakuar për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovet si e bazuar ankesa e propozuesve

të sigurimit te anulohet Aktvendimi i atakuar, dhe çështja ti kthehet në rivendosje ne gjykatën e shkalles e pare.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

-Ankesat është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi/propozuesi i masës së sigurimit në Gjykatën Komerciale të Kosovës, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë, kundër kundërshtarit të masës së sigurimit. Me propozimin për caktimin e masës së sigurimit ka kërkuar caktimin e masës së sigurisë, ashtu që të paditurit “Smart Project ShPK” me NUI 810177304 t’i bllokohen të gjitha xhirollogaritë që i ka të hapura në të gjitha bankat komerciale në Kosovë. Gjithashtu, ka deklaruar se masa e sigurisë është e domosdoshme sepse Kundër propozuesi ka përfituar duke vënë në lajthim dhe mashtruar atë dhe ka rrezik permanent dhe evident që pa caktimin e masës mund të ndër marr veprime në tjetërsimin apo transferimin e mjeteve dhe asetëve nga çka do të pamundësonte realizimin e të drejtës subjektive të propozuesit, duke vlerësuar që është plotësuar kushti nga neni 297 para 1 pika b i LPK.

I Padituri, si kundërshtar i sigurimit, në bazë të njoftimit të gjykatës sipas nenit 305 para. 2 të LPK-së, brenda afatit ligjor paraqiti përgjigje në propozimin për caktimin e masës së sigurimit, me të cilin e ka kundërshtuar atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar.

Gjykata Komerciale–Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve të sigurimit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, Dhomat e shkallës së parë, thekson se Gjykata konstaton se në mbështetje të propozimit, përmes provave të paraqitura mbetet e pa dëshmuar besueshmëria e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit dhe nuk përmbushen kushtet ligjore nga neni 297 i LPK-se për caktimin e saj në siç ka pretenduar dhe propozuar pala paditëse. Gjykata pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës gjeti se i padituri kundër paditësit e kishte filluar procedurën përmbarimore në bazë të faturës në shumën prej 53,100.00€. Përmbaruesi privat e kishte lejuar përmbarimin, ndërsa kjo gjykatë e kishte refuzuar prapësimin e Paditësit dhe e kishte lënë në fuqi urdhrin përmbarimor. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës rrjedh se në atë procedurë përmbarimore i Paditurit si kreditor e ka realizuar shumën e kontestuar.

Përveç kësaj, gjykata nga shkresat e lëndës vërejt se ndër gjyqësit më 16.06.2020 kishin lidhur një kontratë për hartimin dhe zhvillimin e kompleksit afarist hotelier me pikë karburanti në Vlashnje të Prizrenit; i Padituri më 11.01.2022 me Real Estate Kosovo kishin lidhur kontratën për shërbime të revidimit të projektit, si dhe i Padituri më 11.01.2024 me Real Estate Kosovo ShPK kishte lidhur një aneks kontratë. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se nga shkresat lëndës nuk rrjedh se ka rrezik konkret se pa caktimin e masës së sigurisë Paditësit do t’i pamundësohej ose do t’i vështirësohej realizimin i kërkesëpadisë së tij. Kështu, në rend të parë Paditësi nuk ka paraqitur prova se i Padituri do ta tjetërsoj, fsheh ose ngarkoj pasurinë e vet, ose në forma tjera

do ta ndryshoj gjendjen ekzistuese. Në lidhje me këtë gjykata sqaron se, rrezikut lidhur me këto rrethana duhet të jetë konkret e jo i supozuar, pra nuk mjafton vetëm mundësia e përgjithësuar, por duhet të ketë prova se kundërshtari i masës së sigurisë ka ndërmarr veprime ose është duke u përpjekur të marrë veprime për tjetërsimin, fshehjen ose ngarkimin e pasurisë së synuar, ose është duke ndërmarrë veprime konkrete për pamundësimin ose vështirësimin e dukshëm të realizimit të kërkesëpadisë. Prandaj, duke qenë se për caktimin e masës së sigurisë duhet të plotësohen bashkërisht të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 297 i LPK-së, ndërsa Paditësi nuk ka arritur që të argumentojnë plotësimin e tyre në mënyrë kumulative ashtu siç parashihet me dispozitën ligjore të lartcekur, gjykata vendosi që të refuzojë propozimin e Paditësit për caktimin e masës së sigurisë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji gjene se, Dhoma e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së mase se sigurisë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit të propozimit. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shqyrtimi i çështjes nuk janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 297 par.1 pika (a) dhe (b), e të cilat i referohen besueshmërisë së kërkesës apo të drejtës subjektive dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të mund ti pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës, andaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Në raport me këto pretendime ankimore Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se në arsyetimin e aktvendimit të atakuar, në mënyrë të qartë janë dhënë kushtet ligjore që duhet përmbushur për caktimin e masës së sigurimit. Rrjedhimisht propozuesi nuk ka ofruar as fakte dhe dëshmi se ekziston mundësia e shkaktimit të dëmeve apo humbjeve të tilla, përkatësisht për cilat arsye caktimi i masës të sigurisë është i domosdoshëm. Demi konsiderohet i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund te zhdëmtohet ne mënyre te arsyeshme me ane te një kompensimi financiar. Në fakt propozimi në masë të sigurisë, duhet të jetë i besueshëm, ashtu që kërkesa të përfshijë mundësinë e rrezikut të menjëhershëm dhe të pariparueshëm.

Sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i konsideroi si të bazuara pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur shkelje në dëm të palës propozuesi duke mos caktuar masën e sigurisë. Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e shkallës së parë, pasi që gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar vetëm rrethanat nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive. Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të ankuesit në ankesë, Kolegji vlerëson se të njëjtat tërësisht janë e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë se paditësit, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin ndryshe në këtë çështje juridike.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.2266/24 datë 17.12.2024

Kryetari i Kolegjit–gjyqtari
Ramush Bardiqi d. v.